



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_309_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_452_09_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_452_09_10**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 02.11.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Neshmdein Spahiu (shifra e konsumatorit DMI - 7365) nga Mitrovica, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 10.02.2010 ka apeluar përgjigjen e Departamentit për Konsumator – KEK të datës 01.02.2010, duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 05.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë regjistruar njehsorin elektrik nr. 12449051, ndërsa të hapësira e njehsorit të vjetër evidentohet se njehsori paraprak nuk është.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000975 të datës 05.06.2008
- Me datë 13.11.2009 punëtorët e autorizuar kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave të pajisjeve elektrike.
Provë: Procesverbali nr. 394584 të datës 13.11.2009
- Me datë 25.11.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DMI09HP02135, në vlerë prej 1,449.07 €. **Provë:** Fatura DMI09HP02135 e datës 25.11.2009
- Me datë 18.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 01.02.2010, Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit duke u thirrur në procesverbalin nr. 000975 të datës 05.06.2008.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 01.02.2010
- Me datë 10.02.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK
- Me datë 03.09.2010 DMK në ZRRE pas analizës së lëndës së konsumatorit dhe argumenteve të paraqitura ka lëshuar vendimin ZRRE/DMK_V_452_09_10 duke **pranuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-ut që duke u bazuar në analizat e cekura në vendimin e DMK:
 1. Të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DMI09HP02135 e datës 25.11.2009, në vlerë prej 1,449.07 €
- Me datë 02.11.2010 KEK-u ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Apelimi i KEK-ut i datës 02.11.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_452_09_10** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar dëshmi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut dhe kërkon nga KEK-u që të mbetet në fuqi vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK_V_452_09_10**.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar